



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr.36 Akti

Nr. 50 Vendimi

Tiranë, më 27.07.2018

VENDIM

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi

Kryesuese

Olsi Komici

Relator

Lulzim Hamitaj

Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në Tiranë, më datë 24 korrik 2018, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Elsion Sadiku**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Elsion Sadiku, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e tij në seancë dëgjimore publike vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Elsion Sadiku, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Elsion Sadiku, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, duke qenë kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Brunilda Bektashi, Lulzim Hamitaj dhe Olsi Komici. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.

Me vendimin nr. 1 datë 14.12.2017, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Elsion Sadiku, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit, anëtarin Brunilda Bektashi. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Marie Tuma.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet:1) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe

Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); 2) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe 3) Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të hetimit administrativ.

ILDKPKI, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

1. *Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;*
2. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
3. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
4. *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
5. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, dhe ka dërguar një raport të arsyetuar², duke konkluduar mbi *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Elision Sadiku.”*

Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga studimi i çështjes, është konkluduar në tërësi se:

“Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit është konstatuar se subjekti ka kryer deklarime të pasakta të pasurisë, deklarime të pamjaftueshme të të ardhurave, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.

Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive, për shkak të funksionit apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

¹Me shkresën nr. (***) prot., datë 13.11.2017, e përbërë nga 11 fletë, është dërguar raporti i ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

²Me shkresën nr. (***) prot., datë 27.10.2017, dërgohet raporti i DSIK-së për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

³Me shkresën nr. (***) prot., datë 26.12.2017, dërgohet raporti i Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Nga hetimi i aftësive profesionale, pasi u hetua raporti i Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe denoncimet, subjekti i rivlerësimit u gjet “me mangësi”, që konsistojnë në veprimtari hetimore me mangësi deri në cilësi të papranueshme në punë dhe gjykim të dobët.”

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 10.07.2018 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Elsion Sadiku, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua më datë 10.07.2018 mbi përbërjen e trupit gjykues, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike, më datë 20.07.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 24.07.2018, ora 13:00, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht. Ai parashtroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Elsion Sadiku ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Elsion Sadiku, është prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të

Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për këtë subjekt përfshin: (1) vlerësimin e pasurisë, (2) kontrollin e figurës dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Mbledhja e informacioneve dhe provave për vlerësimin e pasurisë

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”, shtojca 2;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) Provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, si nga Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe banka të nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, klinika dentare “(***)” sh.p.k., shoqëria “(***)” sh.p.k., shoqëria “(***)” sh.p.k., Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale të tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., Universiteti “(***)”, Korçë, zyra noteriale, etj.
- ç) Deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- d) Shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

Pas verifikimit administrativ të kryer nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si edhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Elision Sadiku, rezulton se:

Në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 25.01.2017, subjekti deklaroi këto pasuri:

- 1. Bashkëpronar i tokës bujqësore të familjes bujqësore të fituar në bazë të ligjit nr. 7501, si pjesë e familjes bujqësore, e fituar me aktin e marrjes së tokës në pronësi të datës 15.03.1992 (1/5 pjesë e pandarë, sipërfaqja totale 16.350 m². Pjesë takuese 20 %.**

Subjekti ka dorëzuar në dosjen “Vetting” aktin e marrjes së tokës në pronësi, datë 15.03.1992, nga ku rezulton sipërfaqe toke gjithsej 16.350 m².

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni⁴**

Nga korrespondenca e kryer me Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP) dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP) në rrethe në lidhje me pasuri të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur, rezulton se në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të nuk figurojnë pasuri të regjistruara, ndërsa sipas përgjigjes së ardhur nga ZVRPP-ja Kolonjë, në emër të J. A. S. (babai i subjektit) rezultojnë të regjistruara në fshatin Qafëzez, Kolonjë, pasuritë si më poshtë:

- Pasuria nr. (***), e regjistruar në vol. (***), faqe (***), e llojit “Arë”, me sip. 1680 m²;
- Pasuria nr. (***), e regjistruar në vol. (***), faqe (***), e llojit “Arë”, me sip. 2779 m²;
- Pasuria nr. (***), e regjistruar në vol. (***), faqe (***), e llojit “Arë”, me sip. 10 500 m²;
- Pasuria nr. (***), e regjistruar në vol. (***), faqe (***), e llojit “Arë +truall”, me sip. totale 388 m², truall 300 m² dhe ndërtesë 108 m².

Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka dyshime mbi këtë pasuri. Përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjet e ardhura nga institucionet shtetërore.

- 2. Më datë 25.05.2013, blerje pajisjesh dentare nga bashkëshortja për klinikë dentare. Të gjitha pajisjet e nevojshme (unit dentar, autoklavë, stol mjeku, kompresor, aparat plastifikimi, mjete pune etj.) të blera nga shtetasit I. dhe V. B. (të përdorura). Vlera 7.500 euro.**

Burimi i krijimit:

Kursimet e bashkëshortes, të deklaruara në deklaratën periodike të datës 20.03.2009. Paguar nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare. Pjesa takuese 100 %.

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Në deklaratën e interesave private (periodik/vjetor) për vitin 2008, dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.03.2018, personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja e tij M. S., deklaron:

⁴Shiko në dosje shkresën nr. (***), prot., datë 26.12.2017, drejtuar ZQRPP-së Tiranë dhe ZVRPP-ve në rrethe në lidhje me pasuri të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur dhe përgjigjen e ardhur me nr. (***), prot., datë 03.01.18, dhe nr. (***), prot., datë 08.01.2018, ardhur nga ZVRPP-ja Kolonjë.

- a) Para *cash*, dhuratë nga babai për fejesë, në shumën 500.000 lekë, 100 %;
- b) Të ardhura nga puna si mjek stomatologje e punësuar në klinikë private, në adresën Rr. “(***)”, “(***)”, Korçë, në shumën 1.000.000 lekë.

Nga korrespondenca e kryer me 27 bankat e nivelit të dytë dhe institucionet bankare me shkresën nr. (***) prot., datë 21.12.2017⁵, për llogari, depozita, transfertat etj., në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, “Fibank” Korçë, me shkresën nr. (***) prot., datë 28.12.2017, konfirmon gjendjen e llogarisë bankare në datën 24.05.2013, në shumën 18.524,94 lekë, ndërkohë që në datën 25.05.2013, bashkëshortja e subjektit lidh kontratë për blerje pajisjeje dentare me vlerë 7.500 euro.

Komisioni ka hetuar në lidhje me periudhën e punësimit të bashkëshortes së subjektit për periudhën para vitit 2013, nëse ka pasur kursime apo depozita, pagat dhe periudhën e punësimit nga momenti i diplomimit deri në ditën e lidhjes së kontratës për blerjen e pajisjeve dentare.

- Nga korrespondenca e kryer me Bashkinë Korçë, me shkresën nr. (***) prot., datë 29.12.2018, rezulton se subjekti Elision Sadiku dhe znj. M. S. kanë lidhur martesë në datën 22.01.2009.

- Nga korrespondenca e kryer me Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë dhe Arkivin Qendror të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, përkatësisht me shkresat e nisura:

- a) Shkresa nr. (***) prot., datë 29.03.2018; nr. (***) prot., datë 12.04.2018; nr. (***) prot., datë 03.05.2018; nr. (***) prot., datë 23.05.2018; nr. (***) prot., datë 25.05.2018;

dhe shkresat e ardhura:

- b) Shkresa me nr. (***) prot.; vërtetim nr. (***) prot., datë 04.04.2018, nr. (***) prot., datë 30.04.2018; nr. (***) prot., datë 15.05.2018; nr. (***) prot., datë 29.05.2018,

nga hetimi rezulton se znj. M. S. figuron e siguruar, për herë të parë, pranë personit fizik “S. B.” me NIPT (***) , prej datës 01.07.2009, dhe nga kjo datë deri më 31.12.2009 është paguar me pagesë neto prej 15.184 lekësh/muaj.

Është pyetur subjekti (pyetësi nr. 2) nëse bashkëshortja e tij ka qenë e punësuar apo e vetëpunësuar nga momenti i mbarimit të shkollës deri në janar 2010, duke i kërkuar të konfirmojë punëdhënësin, periudhën e punësimit, rrogën bruto dhe atë neto, si dhe dokumentacionin justifikues.

Subjekti, në përgjigjen e tij sqaron se është fejuar dhe ka filluar bashkëjetesën me bashkëshorten që në muajin gusht të vitit 2008. Bashkëshortja ka qenë e punësuar në klinikën dentare “(***)”, me punëdhënësin shtetasin S. B. që prej mbarimit të shkollës në vitin 2006 deri në momentin kur ajo nisi aktivitetin e saj privat si mjek stomatologje (si person fizik). Konkretisht, subjekti shprehet se: “Nga biseda me bashkëshorten (pasi unë jam njohur me të

⁵Shiko në dosje shkresën nr. (***) prot., datë 21.12.2017, drejtuar bankave dhe përgjigjen e ardhur nga “Fibank” Korçë, me shkresën nr. (***) prot., datë 28.12.2017.

në vitin 2008 dhe kam lidhur martesë në vitin 2009), sqaroj se për një periudhë njëvjeçare (2006-2007), bashkëshortja ime ka punuar pa pagesë në këtë klinikë. Gjatë periudhës 2007 deri në qershor 2009, bashkëshortja ka punuar dhe është paguar në shuma të ndryshme, por për shkak se nuk ka qenë e regjistruar nga punëdhënësi në organet tatimore, nuk mund t'u them se sa ka qenë shuma që ajo është paguar, pasi për atë kohë sa kjo është e padokumentuar, gjykoj se çdo informacion i dhënë do të ishte deklarativ nga ana e saj dhe i pasaktë. Në lidhje me këto fakte që sapo deklarova, bashkëlidhur po ju dërgoj një kopje të librezës së punës së bashkëshortes, ku është dokumentuar fillimi i formalizimit të punës së saj (1 korrik 2009)". Shuma prej 1.500.000 lekësh ka qenë e planifikuar për blerjen e pajisjeve dentare të reja, nga të cilat për pajisjet janë përdorur në fakt vetëm 7500 euro, kurse diferenca është përdorur për pagesën e shumës prej 27.200 eurosh për blerjen e banesës".

Fotokopja e librezës së punës e depozituar nga subjekti, bashkëlidhur pyetësorit nr. 2, konfirmon se znj. M. S. ka qenë e punësuar pranë klinikës dentare "S. B." prej datës 01.07.2009 deri më 28 prill 2013.

❖ Rivlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Pavarësisht provave dhe sqarimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si: deklarata noteriale e pronarit të klinikës dentare "(***)" dhe të dy klientëve të saj, listës së klientëve të klinikës dentare, fotokopje e librezës së punës së bashkëshortes, sqarimeve të pyetësorëve, etj., konfirmohet fakti se nuk rezulton e provuar me asnjë dokumentacion ligjor, si dhe nga asnjë institucion shtetëror apo privat, që bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. M. S., të ketë qenë e punësuar, punësim për të cilin të ketë paguar detyrimet tatimore, para datës 01.07.2009 e, për rrjedhojë, të ketë përfituar pagesa përpara kësaj date.

Në bazë të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës: "*Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore...."*

Sa më sipër, subjekti nuk e justifikon si burim të ligjshëm financiar shumën e paguar prej 7.500 eurosh për blerjen e pajisjeve dentare në vitin 2013 nga bashkëshortja M. S., me kursimet e bashkëshortes para vitit 2009. Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar në vitin 2008 të ardhura nga paga prej 1.000.000 lekësh dhe dhuratë cash nga babai për fejesë në shumën 500.000 lekë, por nuk rezulton e provuar me asnjë dokumentacion ligjor, si dhe nga asnjë institucion shtetëror apo privat, që bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. M. S., të ketë qenë e punësuar, punësim nga i cili të ketë përfituar pagesa mujore për të cilat të ketë paguar detyrimet tatimore, para datës 01.07.2009 e, për rrjedhojë, të ketë përfituar pagesa përpara kësaj date në shumën totale prej 1.000.000 lekësh.

Subjekti i rivlerësimit rezulton se ka kryer deklarim të pasaktë të burimeve financiare për blerjen e pajisjeve dentare nga ana e personit të lidhur, bashkëshortes së tij, znj. M. S., si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për kryerjen e këtij investimi.

3. Më datë 09.11.2013, lidhje “kontratë kapari” pasuri e paluajtshme, për blerjen e apartamentit (ende i paregjistruar), me sipërfaqe 108 m², nga shtetasja H. Gj., e përfaqësuar me prokurë nga shtetasi V. Gj., në vlerën 34.000 euro, duke paguar fillimisht 80 % të vlerës së apartamentit (27.200 euro).

Burimi i krijimit:

- Shuma prej 13.000 eurosh, kthyer subjektit nga anulimi i kontratës për premtim shitjeje, të datës 10.10.2011, me shoqërinë ndërtuese “(***)” sh.p.k.;
- Hua në shumën 1.000.000 lekë (aktualisht e shlyer) nga vjehri M. P.;
- Kursimet e subjektit gjatë vitit 2012 dhe gjatë vitit 2013;
- Një pjesë e shumës së lekëve të ngelura bashkëshortes, pas blerjes së pajisjeve për klinikë dentare;
- Në vitin 2016 është paguar edhe shuma prej 3.000 eurosh. Për këtë pagesë kanë shërbyer kursimet e vitit 2016 deri në momentin e pagesës dhe *overdraft*-i (mbitërheqja) i marrë në këtë vit.
“Në lidhje me këtë apartament janë për t’u paguar edhe 3.800 euro detyrim, i cili do të lindë në momentin e regjistrimit dhe kalimit të pronësisë, referuar kontratës së kaparit. Për këtë pagesë është marrë kredia që do të sqarohet më poshtë”, - deklaron subjekti.
- Në lidhje me këtë pasuri është shpenzuar për mobilim vlera 900.000 lekë, nga kursimet e vitit 2015 dhe *overdraft*-i i këtij viti (sipas deklarimeve në Deklaratën-Vetting).

Vlera e asetit 30.200 euro + 900.000 lekë, shpenzime për mobilim. Pjesa takuese 100 %.

❖ Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga korrespondenca e kryer me ZVRPP-në Korçë⁶ rezulton se nuk ka pasuri të regjistruara në emër të subjektit Elsion Sadiku dhe personave të lidhur me të, por ka pasuri të regjistruara në emër të vjehrit të subjektit, M. Gj. P.

Subjekti deklaron “Kontratë për premtim shitjeje”, datë 10.10.2011, me shoqërinë “(***)” sh.p.k., e anuluar më datë 06.11.2013, duke marrë mbrapsht shumën e paguar deri në ato momente, konkretisht 13.000 euro, sipas mandatpagesës nr. (***), datë 06.11.2013, të paraqitur nga vetë subjekti.

Nga korrespondenca e kryer me shoqërinë “(***)” sh.p.k.⁷ në lidhje me pagesën dhe anulimin e kontratës “Premtim shitjeje”, datë 10.10.2011, për apartamentin me sipërfaqe 73.4 m², konfirmohet kontrata premtim shitjeje, e lidhur më datë 10.10.2011 ndërmjet investitorit “(***)” sh.p.k., me përfaqësues z. V. Q. dhe porosites z. Elsion Sadiku, i cili ka porositur një apartament me sipërfaqe totale prej 83 m², me çmim 26.500 euro.

⁶Shiko shkresën nr. (***) prot., datë 26.12.2017, drejtuar ZVRPP-së Korçë në lidhje me pasuri të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur. Përgjigjja e ardhur nr. (***) prot., datë 15.01.2018, nga ZVRPP Korçë.

⁷ Shiko shkresën nr. (***) prot., datë 17.01.2018, drejtuar shoqërisë “(***)” sh.p.k., dhe përgjigjen e ardhur nr. (***) prot., datë 25.01.2018.

Për blerjen e këtij apartamenti, sikurse konfirmohet dhe nga mandatarkëtimet bashkëlidhur kontratës së mësipërme, subjekti ka paguar përkatësisht:

- 2000 euro, sipas mandatarkëtimit nr. (***) , datë 03.05.2011;
- 8000 euro, sipas mandatarkëtimit nr. (***) , datë 06.10.2011;
- 3000 euro sipas mandatarkëtimit nr. (***) , datë 05.08.2013.

Sipas shkresës së mësipërme të shoqërisë, kjo kontratë premtim-shitjeje është anuluar me pëlqimin e të dyja palëve dhe shumat e paguara (në total 13.000 euro) iu kthyen z. Elsion Sadiku me mandat pagese nr. (***) , datë 06.11.2013.

Subjekti ka deklaruar se apartamenti i blerë me kontratën e kaparit, datë 09.11.2013, paguar pjesërisht, është akoma i paregjistruar në ZVRPP Korçë dhe se, sipas kontratës, pagesa e fundit do të bëhet kur të mbarojë ndërtimi.

Nga korrespondenca e kryer me shoqërinë “(***)” sh.p.k. konfirmohet kontrata e lidhur me znj. H. Gj. (H. Gj. është pala shitëse, nga e cila ka blerë apartamentin subjekti i rivlerësimit), si dhe konfirmon se pallati ka mbaruar dhe është regjistruar në ZVRPP Korçë.⁸

Nga korrespondenca e kryer me noterin B. Z.⁹ dhe me BKT¹⁰-në, konfirmohet kontrata e kaparit midis znj. H. Gj. në cilësinë e shitëses dhe z. Elsion Sadiku në cilësinë e blerësit, me objekt shitjen e një apartamenti në ndërtim e sipër nga shoqëria “(***)”, kundrejt çmimit 34.000 euro. Konfirmohet gjithashtu derdhja në llogarinë e noterit dhe tërheqja përsëri, nga ana e subjektit, e këstit prej 3.800 eurosh.

Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka derdhur nëpërmjet transaksionit bankar në BKT për kontratën e kaparit gjithsej 27.200 + 3.000 euro, në total vlerën 30.200 euro, dhe shumën prej 3.800 eurosh e ka ngurtësuar në llogarinë e noterit dhe pastaj e ka tërhequr përsëri.

❖ Rivlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Në lidhje me:

- Burimin e krijimit, Hua në shumën 1.000.000 lekë (aktualisht e shlyer) nga vjehri M. P. Rezulton se shtetasi M. P. (vjehri i subjektit) ka pasur mjete të mjaftueshme financiare për dhënien e kësaj huaje, sepse me kontratë shitjeje nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 13.05.2003, M. P. ka shitur një apartament në Korçë me vlerë 2.800.000 lekë, si dhe ka pasur mjete të mjaftueshme financiare në llogaritë bankare.

⁸ Në dosje ndodhet shkresa nr. (***) prot., datë 25.1.2018, drejtuar shoqërisë “(***)” sh.p.k., dhe përgjigjja e ardhur më datë 06.02.2018.

⁹ Shiko në dosje shkresën e Komisionit nr. (***) prot., datë 17.1.2018, dhe përgjigjen e ardhur me nr. extra prot., datë 30.01.2018.

¹⁰ Shiko në dosje shkresën nr. (***) prot., datë 09.01.2018, ardhur nga BKT-ja pas kërkesës së bërë nga ana jonë me shkresën nr. (***) prot., datë 21.12.2017, “Kërkesë për informacion”.

- Burimin e krijimit, që ka të bëjë me kursimet gjatë vitit 2012 dhe vitit 2013, sqarojmë se kursimet prej 550.000 lekësh janë marrë në konsideratë ato të deklaruara në deklaratën e interesave private (periodik/vjetor) për vitin 2012, si dhe të ardhurat për vitin 2013. Nga kjo shumë (kursimet e vitit 2012) janë paguar 3000 euro si këst pagese në vitin 2013 për apartamentin e prenotuar në bazë të kontratës për premtim shitjeje, datë 10.10.2011, me shoqërinë “(***)” sh.p.k., për rrjedhojë shuma e mbetur, prej rreth 150.000 lekësh, duke shtuar edhe të ardhurat e realizuara në vitin 2013, nuk mbulon diferencën e mbetur për t’u paguar për apartamentin për të cilin është lidhur kontratë kapari më datë 09.11.2013, sepse balanca financiare (të ardhura – shpenzime) për vitin 2013, e përllëgaritur nga Komisioni, rezulton me *minus - 317 328 lekë* dhe, për më tepër, nga analiza financiare e depozituar nga vetë subjekti në Komision me shkresën nr. (***) prot., datë 18.07.2018, viti 2013 rezulton me një balancë financiare negative prej – *1 736 832 lekësh*.
- Burimin e krijimit, “Një pjesë e shumës së lekëve të ngelura bashkëshortes, pas blerjes së pajisjeve për klinikë dentare”, ky deklaram rezulton të jetë i pasaktë sepse, sikurse e kemi argumentuar në pikën që ka të bëjë me blerjen e pajisjeve dentare, kursimet e bashkëshortes në vitin 2008, nga të cilat vetëm shuma prej 500.000 lekësh (dhuratë *cash* e babait për fejesë), është burim financiar nga të ardhura të ligjshme, nuk janë të mjaftueshme as për blerjen e pajisjeve dentare në shumën 7.500 euro dhe, për rrjedhojë, është e pamundur që me to të jetë paguar dhe një pjesë e çmimit të apartamentit të prenotuar në bazë të kontratës së kaparit të datës 09.11.2013.

Përveç vlerës prej 30.200 eurosh, vlerë e paguar për apartamentin, subjekti deklaron edhe 900.000 lekë, plus shpenzime, për mobilim shtëpie. Subjekti, në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, deklaron se nuk disponon fatura për arredimin e shtëpisë ku aktualisht banon, pra nuk paraqet asnjë dokumentacion, si faturë tatimore blerjeje etj., që të justifikojë blerjet e mobilieve.

Nga sa më sipër, *subjekti rezulton se ka kryer deklaram të pasaktë të burimeve financiare për pagimin e çmimit prej 30.200 eurosh për blerjen e apartamentit me kontratën e kaparit të datës 09.11.2013, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për kryerjen e këtij investimi.*

- 4. Automjeti me targa (***) , i llojit “Peugeot 307”, viti i prodhimit 2002, blerë sipas kontratës noteriale nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 29.07.2010. Vlera 400.000 lekë. Pjesa takuese 100 %.**

Burimi i krijimit:

Në Deklaratën-Vetting, subjekti nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti.

❖ Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga korrespondenca e kryer me DPSHTRR¹¹-në rezulton si palë shitëse në kontratë shtetasi G.Ç., i cili përfaqësohet me prokurë të posaçme me nr. (***) rep., nr(***)kol., datë 25.04.2009, nga Elision Sadiku, i cili është edhe pala blerëse e automjetit.

Në deklaratën e interesave private (periodik/vjetor) të vitit 2010, subjekti ka deklaruar automjetin e mësipërm të blerë më datë 29.07.2010 për çmimin 400.000 lekë me të ardhurat e siguruara nga shitja e automjetit të mëparshëm.

Nga komunikimi elektronik me subjektin e rivlerësimit, ky i fundit ka depozituar në Komision:

- kontratë shitblerjeje nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 18.02.2008, të automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë (***), blerë nga subjekti, kundrejt çmimit 450.000 lekë, shitësit A. B.;
- kontratë shitblerjeje datë 06.03.2009, e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë (***), shitur nga subjekti Elision Sadiku, kundrejt çmimit 400.000 lekë, blerësit A. R.

❖ Rivlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Shuma prej 400.000 lekësh rezulton e padeklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave private (periodik/vjetor) të vitit 2009. Gjithashtu nuk rezultoi e provuar me dokumente ligjore pretendimi i subjektit se këtë shumë e ka paguar që në datën 25.04.2009, për blerjen e automjetit me targa (***), i llojit “Peugeot 307”, blerë sipas kontratës noteriale nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 29.07.2010, për çmimin 400.000 lekë.

Në përfundim të hetimit administrativ, nga analiza e provave të administruara rezultoi se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm të të ardhurave në deklaratën e interesave private (periodik/vjetor) të vitit 2009, duke mos deklaruar vlerën prej 400.000 lekësh të përfituar nga shitja e automjetit në pronësi të tij.

5. Gjendja cash, në momentin e plotësimit të deklaratës, e krijuar nga tërheqja e pjesshme e kredisë së marrë në “Credins Bank”, më datë 27.9.2016. Vlera 200.000 lekë. Pjesa takuese 100 %.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka dyshime mbi këtë vlerë, pasi subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e gjendjes cash në shumën 200.000 lekë.

6. Gjendja e disponueshme në llogarinë rrjedhëse, në “Credins Bank”, në momentin e deklaramit, e krijuar nga kontrata e overdraft-it dhe një pjesë e kredisë së patërhequr. Vlera 370.674 lekë. Pjesa takuese 100 %.

Nga hetimi i Komisionit nuk ka dyshime mbi gjendjen në këtë llogari rrjedhëse.

¹¹Shiko për më tepër shkresën nr. (***) prot., datë 19.3.2018, drejtuar DPSHTRR dhe përgjigjen e ardhur nr. (***) prot., datë 23.03.2018 nga Drejtoria Rajonale e Transportit Korçë.

7. **Kontratë huapërdorjeje, nr. (***) regj., nr. (***) kol., datë 18.01.2017, pa shpërblim, midis shtetasit M. P. (vjeërri) dhe personit fizik “M. S.”, të një njësie të peregjistruar, me sipërfaqe 48 m², e ndodhur në Lagjen nr. (***), Rr. “(***)”, Korçë. Pa shpërblim.**

*Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi se shtetasi M. P. (vjeërri i subjektit) ka pasur mjete të mjaftueshme financiare për blerjen e pasurisë së paluajtshme të llojit “Njësi” të peregjistruar në ZVRPP Korçë, me sipërfaqe 48 m², e ndodhur në Lagjen nr. (***), Rr. “(***)”, Korçë, sepse:*

- a) *Me shkresën nr. (***) prot., datë 06.04.2018, ardhur nga DPPP¹²-ja konfirmohet transaksioni bankar në emër të M. Gj. P. me “Intesa Sanpaolo Bank” për “Blerje dyqani për vajzën”, në vlerë 2.000.005,74 lekë më datë 02.11.2016;*
- b) *Me kontratë shitjeje nr. (***) rep., nr. (***) kol., datë 13.05.2003, M. P. ka shitur një apartament të ndodhur në qytetin e Korçës me vlerë 2.800.000 lekë.*

8. **Marrëveshje huaje në llogari rrjedhëse (overdraft) me “Credins Bank”, e lidhur më datë 27.5.2016, në shumën 300.000 lekë, me qëllim përballimin e shpenzimeve dhe pagesën e shumës prej 3.000 eurosh, të kryer gjatë vitit 2016, për apartamentin e deklaruar më sipër, afati 12-mujor, me interes 14 %. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer 300.000 lekë.**

Nga hetimi i Komisionit përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin përkatës.

9. **Kontratë kredie, nr. (***) datë 27.9.2016, në shumën 1.050.000 lekë, me qëllim shlyerjen e kështit të fundit të papaguar për blerjen e apartamentit të deklaruar më sipër (si dhe për të mbuluar overdraft-in e përmendur më sipër). Pa kolateral, dorëzanëse bashkëshortja. Me afat 36-mujor. Interesi 6.8 %. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer: 943.618,24 lekë.**

Nga hetimi i Komisionit përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin përkatës.

10. **Deklarimi i të ardhurave të përfituara nga subjekti i rivlerësimit nga Shkolla e Magjistraturës**

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës si të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën 2004 - 2006 shumën prej 928.800 lekësh. Në deklaratën e interesave private (periodik/vjetor) të vitit 2006, subjekti ka deklaruar si të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës, për periudhën 01.01.2006 - 04.10.2006, shumën prej 354.660 lekësh.

¹²Për më tepër, shiko në dosje shkresën nr. (***) prot., datë 06.04.2018, ardhur nga DPPP-jë.

❖ Rivlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Në përfundim të hetimit administrativ, nga analiza e provave të administruara rezultoi se subjekti ka deklaruar dy herë të ardhurat e përfituara nga Shkolla e Magjistraturës për vitin 2006, konkretisht një herë të përfshirë në shumën totale prej 928.800 lekësh për vitet 2004 - 2006, të deklaruar nga subjekti në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës dhe një herë në deklaratën e interesave private (periodik/vjetor) të vitit 2006 në shumën prej 354.465 lekësh.

Sa më sipër, rezultoi se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë të të ardhurave nga Shkolla e Magjistraturës në deklaratën e interesave private (periodik/vjetor) të vitit 2006, duke deklaruar përsëri si të ardhura shumën prej 354.465 lekësh, të cilën e kishte deklaruar një herë në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, si të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën 2004 - 2006.

- 11. Deklarimi i të ardhurave të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit, znj. M. S., nga paga si mjek stomatologe e punësuar në klinikën private “(***)”, në deklaratën e interesave private (periodik/vjetor) të vitit 2009, në shumën prej 540.000 lekësh.**

❖ Hetimi i kryer nga Komisioni

Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga analiza e provave të administruara, rezultoi se bashkëshortja e subjektit, në cilësinë e personit të lidhur, figuron e siguruar pranë personit fizik “S. B.” me NIPT (***) , prej datës 01.07.2009 deri më 31.12.2009, me pagesë neto prej 15.184 lekësh/muaj.

Ky fakt konfirmohet edhe nga fotokopja e librezës së punës, e depozituar nga subjekti bashkëlidhur pyetësorit nr. 2, që konfirmon se znj. M. S. ka qenë e punësuar pranë klinikës dentare “S. B.” prej datës 01.07.2009 deri më 28 prill 2013.

❖ Rivlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Në bazë të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore...”*

Sa më sipër, rezulton se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë të të ardhurave të personit të lidhur, bashkëshortes së tij, znj. M. S., në deklaratën e interesave private (periodik/vjetor) të vitit 2009 për shumën (540.000 - 91.104) 448.896 lekë.

- 12. Në lidhje me analizën financiare për çdo vit deklarimi, konkretisht:**

Analiza financiare është bërë mbi bazën e përlllogaritje së të ardhurave, shpenzimeve, vlerave të pasurive të paluajtshme e të luajtshme, duke përfshirë dhe likuiditetet e padeklaruara, për subjektin dhe personat e lidhur me të, me qëllim evidentimin e vlerave të pajustificuara me burime të ligjshme. Konkretisht:

Për vitin 2011.

	ANALIZA FINANCIARE	Viti 2011
1	Të ardhurat	1.689.618
	- Paga e subjektit të rivlerësimit	1.494.014
	- Paga e bashkëshortes	195.604
2	Ndryshimi i pasurisë	1.369.141
	- Këst për blerjen e shtëpisë në ndërtim	1.383.000
	- Pakësuar gjendja e likuiditeteve në bankë	- 13.859
3	Detyrimet	0
4	Ndryshimi i pasurisë neto	1.369.141
5	Shpenzimet	600.107
	- Shpenzime minimale për konsum familjar	560.000
	- Për udhëtime jashtë vendit	40.107
7	Diferenca (1-2+3-4)	(-279.630)

Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga analiza e provave të administruara rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të paguar kaparin në investim për blerjen e pasurisë së paluajtshme dhe shpenzimet jetike, sepse balanca financiare e këtij viti rezulton negative në shumën -279 630 lekë. Subjekti nuk ka deklaruar se ka bërë pakësim të likuiditeteve cash. Për më tepër, nga analiza financiare e depozituar nga vetë subjekti në Komision me shkresën nr. (***) prot., datë 18.07.2018, viti 2011, rezulton me një balancë financiare negative prej – 320 767 lekësh.

Për vitin 2013.

	ANALIZA FINANCIARE	Viti 2013
1	Të ardhurat	1.500.645
	- Paga e subjektit	1.413.178
	- Paga e bashkëshortes	46.515
	- Dieta nga FBI	40.952
2	Ndryshimi i pasurisë	2.986.610
	- Pagesë këst për blerje shtëpie, që është në ndërtim	420.630
	- Anulim i kontratës së blerjes së apartamentit	-1.803.630
	- Blerja e pajisjeve dentare me vlerë 7500 euro	1.051.575
	- Lidhja e kontratës së kaparit me vlerë 34.000	4.767.140
	- Pakësuar gjendja e likuiditeteve cash	-1.449.105
3	Detyrimet	1.953.428
	- Borxhi i marrë vjehtit	1.000.000

	- Detyrimi që i ka mbetur shoqërisë sipas kontratës së kaparit 6.800 euro	953.428
4	Ndryshimi i pasurisë netto	1.033.182
5	Shpenzimet	784.791
	- Shpenzime jetike, sipas ILDKPKI-së	777.780
	- Udhëtime jashtë shtetit	65.899
7	Diferenca (1-2+3-4)	(- 317.328)

*Subjekti rezulton me mungesë burimesh financiare të ligjshme për të vendosur pasurinë e paluajtshme e të luajtshme, investime me fonde të pajustificuara, me të ardhurat vjetore të vitit 2013. Për më tepër, nga analiza financiare e depozituar nga vetë subjekti në Komision me shkresën nr. (***) prot., datë 18.07.2018, viti 2013 rezulton me një balancë financiare negative prej – 1 736 832 lekësh.*

Rezultati përfundimtar në lidhje me vlerësimin e pasurisë

Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me rivlerësimin e pasurisë ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit:

- ✓ Ka pasaktësi në deklarimin e burimeve financiare, deklarim të pamjaftueshëm të të ardhurave, ka deklaruar burime financiare të paligjshme e, për rrjedhojë, ka burime financiare të ligjshme të pamjaftueshme për kryerjen e investimeve përkatëse.
- ✓ Nga analiza financiare rezulton se për vitet 2011 dhe 2013 subjekti, me të ardhurat e fituara nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, huamarrjet, kreditë, dhuratat, nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve të deklaruara, si dhe për shpenzimet e kryera.

Bazuar në sa më lart, në përfundim të procesit të rivlerësimit për kriterin e pasurisë, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Elsion Sadiku, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës

Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konkluduar mbi “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Elsion Sadiku”. Ky raport është deklasifikuar¹³ në datën 30.01.2018.

Për vlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Elsion Sadiku, është kryer një proces i mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi, duke bërë disa verifikime mbi pastërtinë e figurës, duke

¹³Vendimi nr.25, datë 30.01.2018.

hetuar mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale).

Rezultati përfundimtar për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës si prokuror.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në gjetjet dhe pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, duke rishikuar tri dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe me shkresën me nr. (***) prot., datë 26.12.2017, ka përcjellë pranë Komisioni një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Elsion Sadiku, për periudhën 08.10.2013 deri më 08.10.2016.

I. Raporti për analizën e aftësive profesionale të subjektit, i kryer nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, është bazuar te:

- 1) Formulari i vetëdeklarimit, 3 (tri) dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) 5 (pesë) dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Nga kjo analizë konstatohet:

1. Aftësitë profesionale

Subjekti i rivlerësimit, z. Elsion Sadiku, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se bën referim të saktë dhe të drejtë në normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në përgjithësi, analizon normën penale të zbatueshme, në raport me faktet dhe provat, duke bërë referime dhe në ligje të tjera që kanë lidhje me çështjen konkrete.

Vlerësimi i punës së subjektit të rivlerësimit nga Prokurori i Përgjithshëm, për vitet 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, është në nivelin “Shumë mirë”.

Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Elsion Sadiku, ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet, kërkesat dhe aktet e tjera të përpiluara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai respekton përgjithësisht mirë rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsytimit të aktit procedural të prokurorit. Struktura është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Përgjithësisht, përmbajtja e akteve është gjithëpërfshirëse dhe analizon në tërësi rrethanat e faktit. Në tekstet e akteve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurori. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore.

2. Aftësitë organizative

Subjekti i rivlerësimit, z. Elsion Sadiku, në periudhën e rivlerësimit, 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e prokurorit në Njësinë e Përbashkët Hetimore, duke hetuar e përfaqësuar në gjykim kryesisht vepra penale të lidhura me korrupsionin dhe krimin ekonomik financiar. Për shkak të detyrës së drejtuesit të Njësisë së Përbashkët Hetimore, ka qenë njëkohësisht edhe zëvendësdrejtues i Prokurorisë Korçë dhe ka ushtruar kontrollin e dosjeve të përfunduara, jo vetëm nga prokurorët e Njësisë së Përbashkët Hetimore, por edhe të prokurorëve të tjerë të caktuar nga drejtuesit e Prokurorisë.

Sa u përket të dhënave statistikore, janë deklaruar nga prokurori Elsion Sadiku 218 çështje të caktuara përgjatë viteve 2014 - 2016, ka përfunduar 213 çështje dhe ka mbartur gjithsej 5 çështje të vitit 2016 për vitin 2017.

Në dosjet e vëzhguara evidentohet aftësi në organizimin e punës, respektim i afateve hetimore dhe përpjekje për të zgjidhur në mënyrë të drejtë çështjen. Edhe në rastet e procedimit penal, ku janë zgjatur afatet hetimore, vendimi është i arsyetuar, duke përmendur shkaqet që e kanë diktuar atë, në mënyrë plotësisht të justifikuar.

Aftësitë për të kryer procedurat hetimore

Subjekti i rivlerësimit, z. Elsion Sadiku, kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet se nga ana e subjektit të rivlerësimit veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzimore u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme e duke arritur në vendimmarrje objektive. Përgjithësisht, veprimet procedurale janë dokumentuar mirë.

Aftësitë për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve hetimore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Përfshirja në procedim penal nr. (***) i vitit 2013, në të cilin është gjetur mangësi në urdhrin e regjistrimit të procedimit penal dhe emrit të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, ku në pjesën urdhëruese mungon në fakt emri i personit ndaj të cilit zhvillohen hetime.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë, nga ana e prokurorit Sadiku është përmbushur me besnikëri disiplina dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve të tij, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit.

Prokurori Elision Sadiku, gjatë periudhës së rivlerësimit nuk ka pasur masa disiplinore.

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Elision Sadiku. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna që të jetë kërkuar përjashtimi i tij nga hetimi i çështjeve apo nga përfaqësimi në gjykim i tyre.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Në 5 dosjet e vëzhguara, nuk ka të dhëna të plota për mënyrën e komunikimit të subjektit Elision Sadiku me palët e tjera në proces dhe me gjykatën. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

Ka cilësi të mira bashkëpunuese, si dhe është i gatshëm të punojë në grup dhe me agjenci të tjera ligjzbatuese. Është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët.

Subjekti i rivlerësimit, z. Elision Sadiku, ka marrë titullin “Jurist” në Universitetin e Tiranës, ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, profili prokuror. Ai ka deklaruar specializim në të drejtën penale faktin se gjatë tri viteve të fundit është angazhuar në punën e tij si prokuror në hetimin e rasteve të korrupsionit dhe krimit ekonomik-financiar.

Subjekti i rivlerësimit, z. Elision Sadiku, i është nënshtruar programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe ka paraqitur dokumentet që vërtetojnë pjesëmarrjen në këto aktivitete. Gjithashtu, në periudhën e rivlerësimit, ai deklaroi se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, kryesisht në lidhje me veprat penale të korrupsionit, krimit ekonomik-financiar, pastrimit të parave dhe veprave penale kompjuterike, duke shprehur gatishmërinë e tij për t’u rritur nga ana profesionale.

II. Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Elision Sadiku, bazuar në ankesat e subjekteve denoncues si më poshtë:

1. Kallëzimi penal ndaj subjektit Elision Sadiku pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës Parë Pogradec, i bërë nga shtetasi S. P.

Nga korrespondenca me Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. (***) prot., datë 12.02.2018, Komisioni ka marrë dijeni se ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Elision Sadiku, është regjistruar kallëzimi penal nr. (***), i bërë nga shtetasi S. P., më datë 02.10.2017, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec (prokuror i çështjes, S. K.), me vendimin e datës 19.10.2017 ka vendosur “Për mosfillimin e procedimit penal”. Këtë vendim prokurori S. K. e ka bazuar në analizë të provave dhe fakteve, duke çmuar se nga ana e prokurorit Elision Sadiku dhe oficerit të Policisë Gjyqësore, V. M., nuk janë konsumuar elementet e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, as elementet e ndonjë figure vepre tjetër penale dhe, për rrjedhojë, procedimi penal nuk mund të fillojë.

Ky vendim është ankimuar nga kallëzuesi S. P. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, e cila me vendimin nr. (***), datë 11 dhjetor 2017, ka vendosur “Rrëzimin e ankimit të ankuesit S. P.”, duke lënë në fuqi vendimin e prokurorit për “Mosfillimin e procedimit penal”. Ky vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec ka marrë formë të prerë më datë 22.12.2017.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk rezulton të ketë indice për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

- 2. Denoncimi i shtetasit A. D., konstatuar në emisionin investigativ “(***)”, në televizionin “(***)” (çështja penale nr. (***), viti 2014, sipas kallëzimit të shtetasit A. D. për shkeljet dhe parregullsitë e veprimtarisë në Universitetin “(***)” Korçë).**

❖ Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni është njohur me denoncimin e kryer nga shtetasi A. D. në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Shkallës së Parë Korçë nëpërmjet emisionit investigativ “(***)” në televizionin “(***)”, të datës 05.10.2016, në lidhje me shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara gjatë punës së përditshme në Universitetin “(***)” Korçë, si dhe me masterin “e rremë” të dekanit të Universitetit “(***)” të Korçës, z. F. Ç., dhe bashkëshortes së tij, M. C. Ç.

Çështja i ka kaluar për ndjekje subjektit të rivlerësimit, prokurorit Elision Sadiku, i cili me vendimin e datës 09.06.2015 ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. (***), të vitit 2014, të regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Komisioni ka kryer hetim në lidhje me këtë rast dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, pas kërkesës së Komisionit me nr. (***) prot., datë 24.04.2018, ka depozituar me shkresë përcjellëse nr. (***) prot., datë 29.05.2018, kopje të njëzuar me origjinalin të dosjes penale nr. (***) të vitit 2014, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Nga shqyrtimi i dosjes në fjalë, për hetimin e kryer nga subjekti i rivlerësimit, z. Elision Sadiku, në lidhje me këtë kallëzim të shtetasit A. D. rezultoi se në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Korçë është paraqitur shtetasi A. D., i cili ka paraqitur kallëzim penal ndaj rektorit të Universitetit të Korçës, Gj. M., dhe dekanit A. J., të cilët sipas kallëzuesit kanë kryer veprime të kundërligjshme, si më poshtë:

1. Në procesin e kontraktimit të stafit akademik për disa pedagogë, konkretisht T. N., D. K., A. C., E. N.
2. Dhënies me qira të ambienteve brenda Universitetit të të afërmeve të tij me lidhje farefisnore dhe shoqërore.
3. Njësimit i diplomave të pedagogëve F. Ç. dhe bashkëshortes së tij, M. Ç., të cilët rezultojnë të jenë diplomuar në Bullgari, ndonëse nuk e zotërojnë gjuhën bullgare.
4. Janë konsumuar shkelje në tenderët për basorelievin e universitetit dhe pikturave, të cilët janë fituar me pa të drejtë nga shtetasi R. K.

Nisur nga këto akuza, është kryer hetim nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe prokurori i ngarkuar me këtë çështje, subjekti Elision Sadiku, ka vendosur “Pushimin e çështjes penale” datë 09.06.2015, duke arsyetuar se: “...Nuk plotësohen elementet e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K. Penal dhe as të ndonjë vepre tjetër penale”.

Nga verifikimi i akteve të ndodhura në dosje, rezultoi se me shkresën nr. (***) prot., datë 03.06.2014, të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Korçë është dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë materiali kallëzues i shtetasit A. D. në ngarkim të shtetasve Gj. M. dhe A. J.

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Nga hetimi i kryer nga ana e Komisionit rezultoi se:

Së pari: Në lidhje me hetimin e pretendimit të kallëzuesit për veprime të kundërligjshme nga ana e rektorit të Universitetit të Korçës për rastet e dhënies me qira të ambienteve brenda territorit të Universitetit “(***)” Korçë, shtetasve A. M. dhe F. Q.

Nga hetimi i Komisionit nuk rezultoi të ketë indice për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Së dyti: Në lidhje me hetimin e pretendimit se dekani (atë kohë, sot është rektori) A. J. ka punësuar si pedagog të brendshme vajzën e tij, A. C. (J.).

Nga hetimi i Komisionit rezultoi se:

Dekani i Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, z. A. J., me shkresën më datë 26.11.2012 i ka kërkuar rektorit të Universitetit “(***)” shpalljen e konkursit për vend vakant për personel akademik, pedagog i gjuhës angleze në Departamentin e Gjuhëve të Huaja të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë.

Me shkresën nr. (***) prot., datë 03.12.2012, rektori i Universitetit në detyrë, Gj. M., dërgon pranë Agjencisë së Prokurimeve Publike Tiranë “Shpallje konkursi për personel akademik”, duke përcaktuar edhe kriteret, duke u shpallur ky njoftim në Agjencinë e Prokurimit Publik në Buletinin e Njoftimit Publik të datës 10 dhjetor 2012.

Me urdhrin nr. (***), pa datë, është ngritur nga dekani A. J. komisioni *ad hoc* për vlerësimin e kandidaturave për personel akademik të brendshëm në Departamentin e Gjuhëve të Huaja.

Me procesverbalin e datës 07.01.2013, Komisioni ka bërë vlerësimin e kandidatëve që kanë marrë pjesë në konkurrim.

Me shkresën nr. (***) prot., datë 08.01.2013, dekani A. J. i dërgon emrin e fituesit, A. C., rektorit Gj. M.

Me vendimin nr. (***), datë 11.01.2013, “Për emërim personeli akademik” rektori Gj. M. emëron zj. A. C. personel akademik me kohë të plotë, kategoria “Lektor”, niveli c/1, në Departamentin e Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë.

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij të dërguara në rrugë elektronike dhe të depozituara në Komision me nr. (***) prot. datë 20.07.2018, sqaron se: *“Ekzistenca e situatës së konfliktit të interesit për shkak të punësimit pranë të njëjtës institucion të anëtarëve të një familjeje apo personave që kanë lidhje fisnore me njëri-tjetrin mund të përbëjë sjellje që cenon etikën apo elemente të tjera të funksionimit të institucionit, por nuk rezultojnë të ketë asnjë element të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Kjo, pasi nga hetimi në tërësi nuk ka rezultuar të ketë shkelje të normave ligjore që përcaktojnë procedurën e konkurimit dhe punësimit.”*

Nga hetimi i Komisionit nuk rezultojnë të ketë indice për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Së treti: Në lidhje me pretendimin e kallëzuesit se janë kryer veprime të kundërligjshme në procesin e kontraktimit si pedagogë të disa shtetasve.

Procedura e rekrutimit të shtetasve të mësipërm si pedagogë është gjetur me probleme edhe nga vetë Drejtoria e Auditimit në Ministrinë e Sportit, Arsimit dhe Rinisë.

Në shpjegimet e tij, subjekti sqaron se: *“Rekrutimi i personelit të jashtëm nuk është bërë me dashje për të shmangur një procedurë konkurrimi, por si nevojë urgjente e procesit mësimor, e lindur në mes të vitit akademik. Gjithashtu, T. N. dhe A. P. janë rekrutuar për një kohë shumë të shkurtër dhe në rastin e shtetasit T. N., rektori ka zgjidhur në mënyrë të menjëhershme kontratën me këtë shtetas, pasi është vënë në dijeni të mungesës së dokumentacionit.”*

Nga hetimi i Komisionit, pavarësisht problematikës së konstatuar, nuk rezultojnë të ketë indice për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

Së katërti: Në lidhje me kallëzimin ndaj rektorit Gj. M., për njësimin e diplomave të shtetasve, pedagogëve F. Ç. dhe M. Ç., të marra në Universitetin shtetëror të Bllagoevgradit, në një kohë kur këta shtetas nuk e zotërojnë gjuhën bullgare.

Në lidhje me këtë kallëzim, vetë subjekti, në vendimin e pushimit datë 09.06.2015, argumenton se: *“Organi procedues u është drejtuar për ndihmë juridike autoriteteve kompetente bullgare dhe më datë 09.04.2015 ka përcjellë kthimin e përgjigjes së autoriteteve bullgare dhe nga administrimi i akteve rezultoi se diplomat e paraqitura në Universitetin “(***)”, Korçë, nga ana e pedagogëve F. Ç. dhe M. Ç., janë po të njëjtat të lëshuara nga Universiteti “(***)”. Nga autoritetet kompetente bullgare janë pyetur edhe disa pedagogë të Universitetit “(***)”, të cilët kanë konfirmuar faktin që i njohin si studentë të huaj të masterit dy shtetasit e mësipërm, gjuha në të cilën ata kanë marrë leksionet dhe dhënë provimet ka qenë në gjuhë ndërkombëtare (anglisht), pasi vetë universiteti e parashikon një gjë të tillë në rregulloren e tij. Këtë fakt e pohojnë në deklaratimet e tyre edhe shtetasit F. Ç. dhe M. Ç., pavarësisht faktit që nuk e njohin gjuhën bullgare, provimet i kanë dhënë në gjuhën angleze, pasi parashikohej në rregulloren e universitetit”.*

Në fashikullin e vendimit të pushimit ndodhen të administruara edhe dokumentet si më poshtë:

- Protokoll për marrje në pyetje të dëshmitarit V. Zh. P., datë 21.01.2015 i cili deklaron se: *“Provimi jepet në gjuhën bullgare. Studenti përgjigjet vetë ose me ndihmën e përkthyesit. Për aq sa unë di, kërkesa për mësimin paraprak të gjuhës bullgare vlen për studentët e huaj për diplomën bachelor”.*
- Protokoll për marrje në pyetje të dëshmitarit I. D. G., datë 22.01.2015 i cili deklaron se: *“Mësimi bëhet në gjuhën bullgare. Nuk mund të jap informacione se në cilën gjuhë kanë bërë studimet studentët e lartpërmendur. **Mbrojtja e tezës është publike dhe bëhet në gjuhën bullgare dhe angleze**”.*
- Protokoll për marrje në pyetje të dëshmitarit S. J. A., datë 12.02.2015 e cila deklaron se: *“Nuk ka kërkesa ligjore që përcaktojnë gjuhën...”.*
- Protokoll për marrje në pyetje të dëshmitarit G. G. A., datë 13.02.2015 e cila deklaron se: *“Gjuha bullgare është e detyrueshme vetëm për studimet bachelor”.*
- Diploma e masterit në Bullgari e shtetasit F. G. Ch. nga Universiteti Jugperëndimor “(***)” Bllagoevgrad, Bullgari, datë 01.03.2005.
- Deklarime para oficerit të Policisë Gjyqësore të shtetasës M. C. Ç., datë 26.07.2014 e cila deklaron se: *“Provimet në Bullgari i kam dhënë në gjuhën angleze, pasi për këtë gjuhë unë kam disa dëshmi, kurse, kualifikime etj”.* Ajo deklaron se nuk e njeh gjuhën bullgare, por ka dëshmi për gjuhën ruse.
- Deklarime të shtetasit F. Ç. para oficerit të Policisë Gjyqësore, datë 26.06.2014 i cili deklaron se: *“Nuk e njoh gjuhën bullgare. Provimet unë i kam dhënë në gjuhën angleze, pasi për këtë gjuhë kam disa dëshmi, kurse, kualifikime etj. Kemi pasur detyrimin që të njihnim dy gjuhë, por duhet të paraqitnim një dëshmi ose certifikatë në njërin prej gjuhëve që dinim dhe unë kam paraqitur certifikatë të gjuhës italiane... Nuk jam shprehur asnjë ditë nga puna (në Universitetin “(***)”), pasi i kam kryer studimet në Bullgari më kohë të pjesshme”.*

Trupi gjykues, pasi arriti në përfundimin se provat e administruara në lidhje me kriterin profesional kishin nivelin e provueshmërisë, me vendimin nr. (***) datë 09.07.2018, vendosi të përfundojë hetimin kryesisht, duke i dërguar subjektit rezultatet e hetimit, duke e njoftuar se, bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, ai ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën për sa më poshtë:

“Sa më sipër, duket se hetimet e kryera nga ana e subjektit nuk janë të plota dhe shteruese sepse nga ana e të kallëzuarve në fashikullin e dosjes nuk na rezulton i dorëzuar ndonjë dokument zyrtar për mbrojtjen e gjuhës angleze, për më tepër që në dosje është dorëzuar vetëm dokument i mbrojtjes së gjuhës italiane.”

Subjekti, në shpjegimet e veta dërguar në komision në datat 18 dhe 20 korrik 2018, argumenton se: *“Vlerësoj se në dosjen hetimore dhe vendimin objekt vlerësimi, janë analizuar të gjitha faktet dhe provat që kanë rezultuar nga hetimi në bazë të të cilave ka rezultuar, nëpërmjet dokumentacionit zyrtar të ardhur nga shteti bullgar nëpërmjet letër-porosisë, se diplomat e shtetasve të mësipërm, të punësuar pranë Universitetit, janë dokumente zyrtare të lëshuara nga universiteti respektiv bullgar... Theksoj se për këtë fakt është kryer, duke administruar dhe vlerësuar të gjithë procedurën e punësimit të tyre, si dhe dokumentacionin përkatës lidhur me vërtetësinë e dëshmimeve në lidhje me shkollimin e tyre, si dhe deklaratimet përkatëse të marra gjatë hetimit... Fakti që në dosje nuk është administruar një dokument që të provonte njohjen e gjuhës angleze, nuk vë në dyshim diplomat objekt hetimi, por vë në dyshim seriozitetin e universitetit ku kanë studiuar dy pedagogët në fjalë, i cili nuk mund të bëhet objekt hetimi, pasi ndodhet në një shtet tjetër dhe mund të bëhet objekt hetimi vetëm i autoriteteve bullgare. Në gjykimin tim, nuk mund të bëhet objekt hetimi, pasi mungesa e dokumentit zyrtar që provon njohjen ose jo të gjuhës angleze, nuk e vë aspak në dyshim origjinalitetin dhe konfirmimin e diplomave të tyre dhe, për rrjedhojë, mungesa ose jo e këtij dokumenti, duhet të jetë objekt i një hetimi administrativ dhe jo penal”.*

Në seancën dëgjimore të datës 24.07.2018, subjekti ka sqaruar, ndër të tjera, se:

“Për sa i përket autenticitetit të diplomave dhe për të na konfirmuar nëse këto diploma janë lëshuar nga ky universitet ose jo, hetimi është bërë nga autoritetet bullgare, të cilat kanë konfirmuar zyrtarisht se këto diploma janë autentike, janë lëshuar nga ky universitet. Në fakt, i gjithë ky procedim penal ka pasur të bëjë vetëm me veprën penale të falsifikimit ose përdorimit të dokumenteve shkollore të falsifikuara.

*Në momentin që, nga autoritetet bullgare është konfirmuar se këto diploma janë dhënë nga Universiteti “(***)”, Bullgari, vepra penale e parashikuar nga neni 187 nuk ekzistonte më. Për sa i përket faktit se nga ana jonë nuk është administruar një dokument zyrtar që të provonte se shtetasit, bashkëshortët, secili prej tyre, e njihte gjuhën angleze apo bullgare, mungesa e një dokumenti të tillë nuk ka sjellë konsumim të një vepre penale dhe objekti i veprimtarisë së prokurorisë në përgjithësi, dhe në rastin konkret, nuk është në shkeljet administrative që mund të ketë bërë realisht universiteti në Bullgari. Janë të vërteta të gjitha ato. Por, objekt hetimi nuk mund të bëhet universiteti bullgar, pasi është objekt hetimi i organeve kompetente bullgare.*

Pra, marrja ose jo e dokumentit për njohjen e gjuhës angleze apo bullgare nuk passjell ndryshim të rezultateve të hetimit. Vendimmarrja në këtë rast do të ishte përsëri e njëjtë.

Për situatën konkrete dhe faktin konkret kemi të bëjmë me veprën penale të parashikuar nga neni 187, nëse kjo ekzistonte “... Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara shkollore”, ku hyn dhe masteri, diploma që bashkëshortët... dhe në momentin që nga ana e autoriteteve bullgare është konfirmuar që këto dy diploma janë lëshuar nga universiteti, nuk ka çfarë të hetohet.”

❖ Rivlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikullin e procedimit penal nr. (***), viti 2014, si dhe nga shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se:

1. Nga subjekti nuk janë kryer hetime të plota e shteruese në lidhje me verifikimin e ekzistencës së kriterëve paraprake për pjesëmarrje e diplomim në Universitetin Jugperëndimor “(***)” Bllagoevgrad, Bullgari. Megjithëse leksionet dhe provimet në këtë universitet bëheshin në gjuhën bullgare dhe atë angleze, të dy shtetasit, M. Ç. dhe F. Ç., kanë deklaruar se nuk e njohin gjuhën bullgare, por i kanë kryer leksionet dhe provimet në gjuhën angleze, por në fashikullin e procedimit penal nuk rezulton që të jetë kërkuar nga subjekti apo e depozituar nga dy deklaruesit e mësipërm ndonjë dokument zyrtar që konfirmon njohjen prej tyre të gjuhës angleze.
2. Duke marrë në konsideratë faktin se shtetasit F. Ç. dhe M. Ç. kanë depozituar përkatësisht dëshmi të gjuhës italiane dhe të asaj ruse a) subjekti nuk ka kryer asnjë hetim në lidhje me faktin nëse këta shtetas kanë dëshmi të gjuhës angleze apo jo; b) subjekti nuk ka kryer asnjë hetim në lidhje me faktin nëse këta shtetas kanë depozituar ose jo dëshmi të gjuhës angleze në Universitetin “(***)” Bllagoevgrad, Bullgari. Kryerja e këtyre hetimeve nga ana e subjektit mund të çonte në indice apo edhe prova për të provuar konsumimin ose jo të veprës penale, siç është “Falsifikimi i dokumenteve”.
3. Denoncuesi A. D., në denoncimin e tij ngre dhe pretendimin se diplomat e lëshuara nga universiteti bullgar dy shtetasit ndoshta i kanë marrë në mënyra të tjera, abuzive. Në lidhje me këtë fakt, subjekti nuk ka ngritur asnjë pistë tjetër hetimi, minimalisht për mundësi paraqitjeje dokumentesh të falsifikuara nga ana e shtetasve F. Ç. dhe M. Ç., me qëllim plotësimin e kriterëve për përfitimin e diplomave të masterit. Për më tepër, nga subjekti nuk është hetuar në lidhje me intensitetin dhe periudhat kohore të ndjekjes së masterit nga këta dy shtetas, të cilët në deklaratimet e tyre deklarojnë se studimet i kanë ndjekur pa shkëputje nga puna, duke mos munguar asnjë ditë në punë

Si konkluzion, bazuar në kriteret e parashikuara në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, rezulton se në lidhje me çështjen e mësipërme, nuk është kryer hetim i thelluar dhe i plotë nga ana e subjektit të rivlerësimit.

3. Denoncimi i shtetasve S. M. dhe N. M. Objekti i denoncimit: Moskryerje të hetimit, dhënie vendimi të padrejtë, shpifje, falsifikim për qëllime përfitimi.

Në denoncimin e ardhur në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. (***) prot., datë 01.12.2017, dosje denoncimi me dokumentacion shoqërues 2 fletë dhe shkresën nga Avokati i Popullit me nr. (***) regj., datë 15.11.2017, denoncuesit pretendojnë se para 5 vjetësh prokurori Elsion Sadiku ka vepruar në mënyrë të padrejtë në gjykimin dhe kallëzimin që ata kanë bërë si familje në drejtim të një punonjësi të zyrës së punës dhe të një ekonomisti, për arsye se burrit të denoncueses, sipas pretendimeve, i kishin marrë padrejtësisht pagesën e një viti asistencë.

Denoncuesit pretendojnë se prokurori i ka marrë të pandehura vajzat e tyre në mënyrë të padrejtë dhe pa filluar mirë hetimin. Ky prokuror, sipas tyre, i ka detyruar vajzat të firmosin në fletët e tij në të cilat shkruheshin se ato pranonin fajë, duke bërë dhe ndërhyrje në deklaratimet e tyre. Denoncuesit pretendojnë se prokurori Elsion Sadiku ka kërkuar 3 lloje ekspertizash, të cilat bien në kundërshtim me të vërtetën. Gjatë kohës që burri i denoncueses, S. M., ka qenë i sëmurë, vajza e madhe e pajisur me prokurë nga babai, ka tërhequr asistencën dhe si rrjedhojë e këtyre hetimeve vajzën e denoncuesve e kishin hequr nga puna ku kishte punuar në Burgun e ri të Korçës në Drenovë për 9 vjet, me detyrë inspektore, si dhe i janë nxjerrë probleme nga Ambasada Amerikane për vizën.

Bashkangjitur denoncimit ndodhet shkresa nr. (***) regj., datë 15.11.2017, e Avokatit të Popullit “Këshillim dhe orientim” drejtuar denoncuesve, nëpërmjet së cilës këshillojnë ankuesin se po patëm ankesa ndaj vendimit gjyqësor, rruga ligjore që duhet të ndjekin është t’i drejtohen një gjykate më të lartë.

Sa më sipër, denoncuesi pretendon për sjellje të padenjë për prokurorin, duke pretenduar dhe pasojën nga kjo sjellje e prokurorit, si “largimi i vajzës së denoncuesve nga puna”.

Nga hetimi i kryer nga Komisioni, *nuk rezulton të ketë indice për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.*

4. Denoncimi i avokatit A. Ll., nr. (*) prot., datë 12.02.2018.**

Avokati A. M. Ll. ka paraqitur denoncim pranë Komisionit me shkresën nr. (***) prot., datë 12.02.2018, kundër subjektit të rivlerësimit, Elsion J. Sadiku, për vendim të padrejtë dhe korrupsion. Sipas denoncuesit, subjekti i rivlerësimit ka vendosur, në kundërshtim me ligjin, “Për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin me nr. (***), datë 31.10.2017, për kryerje akt-ekspertimi me të dhëna dhe rezultate të rreme”.

Sipas denoncimit, shtetasi M. M., i përfaqësuar me prokurë nga avokati A. Ll., ka qenë palë e paditur në një proces civil në Gjykatën e Apelit Korçë. Ekspertët e caktuar nga Gjykata e Apelit, B. T. dhe R. P., sipas denoncuesit, pasi morën detyrat nga gjykata, kanë paraqitur një akt ekspertimi me të dhëna dhe rezultate të rreme. Për këtë arsye, denoncuesi ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë kundër dy ekspertëve, për kryerje ekspertimi me të dhëna dhe rezultate të rreme.

Prokurori Elsion Sadiku, me shkresën nr. (***) prot., me datë 20.11.2017, ka njoftuar z. M. M. për vendimin e “Mosfillimit të procedimit penal të datës 16.11.2017”.

Denoncuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë ku ka kundërshtuar vendimin për “Mosfillimin e procedimit penal”, të marrë nga subjekti Elision Sadiku.

Në përfundim të hetimit gjyqësor, Gjykata, bazuar në nenet 290 e 291 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës së ankuesit M. M. Prishjen e vendimit të datës 16.11.2017 për ‘Mosfillimin e procedimit penal nr. (***) të vitit 2017’ të subjektit Elision Sadiku, duke urdhëruar regjistrimin e procedimit dhe vazhdimin e hetimeve, sipas pjesës arsyetuese të këtij vendimi”*.

Ndaj këtij vendimi, më datë 02.02.2018 ka paraqitur ankim subjekti Elision Sadiku përpara Gjykatës së Apelit Korçë, duke parashtruar pretendimet e tij kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Korçë.

Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. (***), datë 29.05.2018, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës Parë Korçë, kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal për materialin kallëzues me nr. (***), datë 31.10.2017, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë.

❖ **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Trupi gjykues, pasi arriti në përfundimin se provat e administruara në lidhje me kriterin profesional kishin nivelin e provueshmërisë, me vendimin nr. (***) datë 09.07.2018, vendosi të përfundojë hetimin kryesisht, duke i dërguar subjektit rezultatet e hetimit, duke e njoftuar se, bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, ai ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën për sa më poshtë:

“Nga hetimi i kryer nga Komisioni, bazuar edhe në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë nr. (***) datë 24.01.2018, lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit Korçë nr. (***), datë 29.05.2018, rezulton se nga subjekti i rivlerësimit:

1. *nuk është marrë në konsideratë dhe nuk është analizuar mundësia e ekzistencës së veprës penale të kryerjes së ekspertimit të rremë të kryer nga ekspertët e thirrur nga Gjykata;*
2. *nuk është kryer asnjë hetim dhe analizë në lidhje me elementet e aktit të ekspertimit të pretenduar të falsifikuar në lidhje me veprimet faktike të ekspertëve në kryerjen e aktit të ekspertimit për të konkluduar me faktin nëse kemi të bëjmë apo jo me vepër penale;*
3. *ka mangësi në analizimin e fakteve dhe në marrjen e provave të domosdoshme për arritjen e një konkluzioni të saktë e përfundimtar;*
4. *duke marrë në konsideratë faktin se kryerja e ekspertimit të rremë parashikohet si vepër penale, mungojnë hetime të thelluara në lidhje me faktin nëse kemi të bëjmë me dhënie me dashje rezultatesh të rreme apo dhe për qëllim fitimi.*

Në bazë të nenit 42, pika 1, të ligjit nr. 84/2016: *“Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët, vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”*.

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 2 të nenit 73 përcakton se: “Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë, si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën”.

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e tij dërguar Komisionit, si dhe në ato të dhëna në seancën dëgjimore ka argumentuar si më poshtë:

“Së pari: Vendimi për mosfillimin e procedimit penal është marrë në zbatim të parashikimeve të nenit 290/1, germa “ç” dhe nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, ku parashikohet se: “Procedimi penal nuk mund të fillojë... ç) Kur fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale ose kur del e qartë që fakti nuk ekziston;” dhe “1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit.”. Në zbatim të parashikimeve ligjore si më sipër, Prokurori ka marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal brenda afatit 15-ditor, duke arsyetuar në mënyrë tërësore faktet dhe rrethanat e parashtruara nga kallëzuesi dhe duke i vlerësuar ato në raport me parashikimet e ligjit procedural penal dhe ligji penal material. Sqaroj se vendimi i mosfillimit merret pa bërë veprime hetimore (vetëm veprime verifikuese), pasi nëse bëhen veprime hetimore, më pas mund të disponohet vetëm me dërgim çështjeje në gjyq ose kërkesë pushimi në Gjykatë, por jo me vendim mosfillimi.

Së dyti: Në arsyetimin e vendimit analizohen pretendimet e kallëzuesit dhe nga ana e prokurorit, në ushtrim të së drejtës për të vlerësuar faktet objekt kallëzimi në mënyrë objektive dhe të paanshme, është arritur në konkluzionin se pretendimet e kallëzuesit lidhen me kundërshtime për aktin e ekspertimit të kryer gjatë gjykimit në Gjykatën e Apelit Korçë, pretendime këto që janë vlerësuar se duhet të paraqiteshin gjatë procesit civil, duke kundërshtuar aktin e ekspertimit të kryer nga ekspertët dhe/ose të kërkohej kryerja e një riekspertimi në referim të parashikimeve të nenit 229 të K. Pr. Civile. Në këtë aspekt, nga ana e prokurorit është vlerësuar se këto pretendime lidhur me aktin e ekspertimit bëjnë pjesë në ato që vlerësohen si kundërshtime të aktit të ekspertimit dhe mund të paraqiten nga palët në gjykimin civil dhe janë në kompetencën ekskluzive të vlerësimit të gjykatës civile që gjykon themelin e çështjes e cila, pasi i vlerëson pretendimet e palës, mund të vlerësojë nëse ka ose jo vend për përsëritje të ekspertimit, plotësimit të tij apo riekspertim me grup tjetër ekspertësh. Nuk është kompetencë e Prokurorisë të vlerësojë kundërshtimet në lidhje me një akt ekspertimi të kryer në një proces civil.

Së treti: Është vlerësuar se pretendimet e parashtruara nga kallëzuesi në lidhje me veprimtarinë e ekspertëve nuk rezultojnë të mbështetura në fakte dhe rrethana që burojnë nga provat bashkëlidhur kallëzimit. Parashtrimet e kallëzuesit se ekspertët kanë fshehur apo deformuar fakte, bazuar kjo vetëm në pretendimet e tij lidhur me përmbajtjen e aktit janë vlerësuar si elemente që nuk japin indice për ekzistencën e elementeve të veprës penale të “Ekspertimit të rremë” në faktin objekt kallëzimi.

Së katërti: Në vendimin e mosfillimit të procedimit penal është analizuar, ndër të tjera, edhe parashikimi ligjor i nenit 71 të K. Pr. Penale në të cilin parashikohet se: “Vendimi civil i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që gjykon çështjen penale, vetëm për sa i përket faktit nëse vepra ka ndodhur ose jo, por jo për fajësinë e të pandehurit.”

Në referim të këtij parashikimi ligjor, duke marrë parasysh faktin se Gjykata e Apelit në vendimin civil të marrë në përfundim të gjykimit (vendim ky i formës së prerë në referim të parashikimeve të nenit 451, germa “ç” të K. Pr. Civile) e ka konsideruar aktin e ekspertimit të kryer nga ekspertët e kallëzuar si një akt të vlefshëm, duke e bërë atë pjesë integrale të vendimit gjyqësor të saj, si dhe duke vlerësuar faktin që pretendimet e kallëzuesit kanë qenë kryesisht të karakterit kundërshtues në raport me konkluzionet dhe përmbajtjen e aktit, ky fakt nuk mund të mos merret dhe vlerësohet nga prokurori në disponimin e tij mbi procedimin. Kjo, duke marrë parasysh që vendimet e formës së prerë (në rastin konkret Gjykata e Apelit ka bërë pjesë të vendimit dhe aktin e ekspertimit objekt kallëzimi) civile apo penale, janë të detyrueshme për zbatim dhe, për pasojë, nuk mund të mos merren parasysh nga organet e tjera ligjzbatuese.

Së pesti: Në lidhje me konkluzionin se “Nuk është kryer asnjë hetim dhe analizë në lidhje me elementet e aktit të ekspertimit të pretenduar të falsifikuar në lidhje me veprimet faktike të ekspertëve në kryerjen e aktit të ekspertimit për të konkluduar me faktin nëse kemi të bëjmë apo jo me vepër penale;”, referuar vendimit të mosfillimit të procedimit penal objekt vlerësimi, vlerësoj se janë analizuar provat e administruara në kuadër të procesit verifikues para regjistrimit të procedimit penal, dhe është bërë analizë e fakteve objekt kallëzimi, duke vlerësuar që nuk rezultojnë në pretendimet e kallëzuesit në raport me provat e administruara, ekzistenca e elementeve të anës objektive të veprës penale. Në lidhje me nevojën e kryerjes së hetimeve, sqaroj se në procesin e administrimit dhe vlerësimit të fakteve objekt kallëzimi në raport me parashikimet e ligjit procedural penal dhe penal material, para se të konkludohet nëse ka vend për fillimin ose jo të një procedimi penal, ligjvënësi nuk lejon kryerjen e veprimeve hetimore, por kryerjen e veprimeve me karakter verifikues dhe nga përmbajtja e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, si dhe dosja përkatëse që përmban këtë vendim rezulton se Prokuroria ka kryer veprime verifikuese lidhur me faktin e pretenduar. Marrja e provave në referim të parashikimeve të neneve 149 e vijues të K. Pr. Penale është një proces që zhvillohet pasi regjistrohet procedimi penal. Në rastin konkret, duke qenë se nga prokurori është vlerësuar se fakti objekt kallëzimi, pas analizës së tij në raport me parashikimet e ligjit penal, nuk përbën vepër penale dhe për pasojë është konkluduar me mosfillimin e procedimit penal, nuk mund të jenë marrë prova në kuadër të procesit hetimor në referim të neneve 149 e vijues të K. Pr. Penale.

Së gjashti: Në lidhje me konstatimin se: “Ka mangësi në analizimin e fakteve dhe në marrjen e provave të domosdoshme për arritjen e një konkluzioni të saktë e përfundimtar”.

Nga përmbajtja e vendimit vlerësoj se janë marrë në analizë pretendimet e kallëzuesit dhe janë vlerësuar në tërësi, duke iu referuar provave të administruara për efekt të vlerësimit të fakteve objekt kallëzimi, janë analizuar dhe referuar dispozitat ligjore përkatëse që në vlerësimin e prokurorit, nuk lejojnë fillimin e procedimit penal.

Së shtati: Lidhur me konkluzionin se: “Duke marrë në konsideratë faktin se kryerja e ekspertimit të rremë parashikohet si vepër penale, mungojnë hetime të thelluara në lidhje me faktin nëse kemi të bëjmë me dhënie me dashje rezultatesh të rreme apo dhe për qëllim fitimi.”. Vlerësoj që për shkak të faktit që në vendimin e mosfillimit të procedimit penal është analizuar tërësia e faktit, duke u vlerësuar mungesa e elementeve të anës objektive të veprës penale, nuk ka qenë e nevojshme të vijohej analiza në lidhje me elemente të anës subjektive të veprës penale, pasi mungesa e elementeve të anës objektive të figurës së veprës penale bën që fakti të mos përbëjë vepër penale. Në lidhje me konstatimin për moskryerjen e hetimeve për anën subjektive të veprës penale theksoj edhe faktin se, referuar pretendimeve të kallëzuesit, përveç kontestimeve për përmbajtjen e aktit, nuk janë parashtruar prej tij rrethana konkrete apo fakte objekt kallëzimi lidhur me veprimtarinë e paligjshme të ekspertëve me qëllime përfitimi.

Së teti: Në lidhje me faktin që ky vendim për mosfillimin e procedimit penal është prishur me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, nr. (***) , datë 24.01.2018, dhe vendimin nr. (***) , datë 29.05.2018, të Gjykatës së Apelit Korçë, vlerësoj se nuk mund të jap komente për vendimet gjyqësore, pasi veprimtaria e Prokurorisë, sipas ligjit procedural penal, i nënshtrohet kontrollit të Gjykatës, për shkak të ligjit ose me ankesë të palëve, dhe vlerësimet e gjykatës të përcaktuara në një venim të formës së prerë (vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë nr. (***) , datë 24.01.2018, ka marrë formë të prerë më datë 29.05.2018) nuk mund të diskutohen nga palët në proces, por urdhërimet e vendimeve gjyqësore janë të detyrueshme për zbatim. Pala kallëzuese ka ushtruar të drejtën e saj të ligjshme për ankimimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe gjykata, pasi ka vlerësuar faktet dhe shkaqet objekt ankimi, ka ushtruar kompetencën e saj kushtetuese dhe ligjore duke u shprehur me vendim për ankimin objekt shqyrtimi. Për këtë shkak, ligjvënësi ka parashikuar kontrollin e vendimmarrjes së prokurorisë nga një proces gjyqësor të zhvilluar me pjesëmarrjen e palëve, proces gjatë të cilit vlerësohen në tërësi pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe gjykata ka kompetencë dhe të drejtën ekskluzive të vlerësojë faktet. Vlerësimi ndryshe i fakteve nga gjykata nuk përbën në çdo rast konstatim për moskryerje të rregullt dhe me profesionalizëm të detyrës së prokurorisë. Vlerësoj se është situatë krejt e zakonshme dhe e shpeshtë që prokuroria dhe gjykata të ndajnë vlerësime dhe interpretime të ndryshme lidhur me faktin dhe, për këtë shkak, ligji ka parashikuar kontrollin gjyqësor mbi vendimmarrjet e Prokurorisë në çdo fazë të hetimit.

Së nënti: Lidhur me ushtrimin e ankimit ndaj vendimit nr. (***) , datë 24.01.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, vlerësoj se ky veprim nuk përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, por ushtrimin e së drejtës së ankimit, njohur me ligj për palët ndërgjyqëse në procesin penal (në rastin konkret ankuesi dhe Prokuroria e Rrethit), në referim të nenit 291, pika 5, të K. Pr. Penale dhe demonstroi bindjen e brendshme dhe mendimin ndryshe të prokurorit nga disponimi i gjykatës, të cilën e demonstroi vetëm nëpërmjet ankimit në gjykatën më të lartë. Fakti që nga ana e prokurorit, në rastin konkret, është ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, pavarësisht se nuk është parashikuar një rast i tillë si rast përjashtimi prokurori në K. Pr. Penale. Edhe në këtë rast, edhe në raste të tjera, unë personalisht kam hequr dorë si prokuror nga hetimi i çështjes, pasi ai vjen ndesh me bindjen time dhe qëndrimin tim të mëparshëm.”

❖ Rivlerësimi i çështjes nga trupi gjykues

Trupi gjykues, në vlerësim të dokumentacionit, konstatimeve të kryera, pasi analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, arsyeton:

1. Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, madje nuk ka kryer asnjë veprim hetimor që do të çonte në një analizë të plotë e, për pasojë, në një përfundim të saktë, për faktet e kallëzuara nga kallëzuesi M. M. Ai nuk ka hetuar në lidhje me ekzistencën ose jo të fakteve dhe, për rrjedhojë, nuk ka bërë një analizë me qëllim arritjen në konkluzionin nëse kemi të bëjmë ose jo me vepër penale.
2. Subjekti, në arsyetimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal datë 16.11.2017, për rastin konkret, ka hedhur poshtë një figurë të veprës penale, siç është “Ekspertimi i rremë”, parashikuar nga neni 309 i K. Penal.
3. Subjekti, me veprimet dhe mosveprimet e tij, i ka mohuar kallëzuesit të drejtën e rishikimit të vendimit civil, parashikuar nga neni 494/b i K. Pr. Civile.
4. Është i pabazuar arsyetimi i subjektit se nuk mund të hetojë një vendim gjykate të formës së prerë, sepse nuk kemi të bëjmë me një kallëzim penal ndaj një vendimi gjykate, por për kryerje ekspertimi të rremë me të dhëna të rreme. Pavarësisht se vendimi gjyqësor civil, ku është administruar akti i ekspertimit, i pretenduar i falsifikuar, ka marrë formë të prerë, kjo nuk përjashton mundësinë e ekzistencës së veprës penale të ekspertimit të rremë të kryer nga ekspertë të thirrur nga Gjykata. Kallëzuesi ka kërkuar ndjekje penale për shtetasit R. P. dhe B. T. në cilësinë e ekspertëve të thirrur nga Gjykata e Apelit Korçë, për paraqitje akt ekspertimi me të dhëna dhe rezultate të rreme.
5. Pavarësisht aspektit civil të aktit, fakti se në organin procedues është paraqitur një kallëzim penal për ekzistencën e një vepre penale, që lidhet me këtë akt dhe në kuadër të një hetimi penal, prokurori është i detyruar ligjërisht t’u japë përgjigje pretendimeve të kallëzuesit për ekzistencën ose jo të veprës penale të ekspertimit të rremë.
6. Pretendimi nga ana e kallëzuesit për pasqyrim të deformuar nga ana e ekspertëve të thirrur nga Gjykata, të të dhënave pasurore, përfshirë edhe kufijtë, si rezultat i një ballafaqimi jo korrekt dhe të qëllimshëm nga ana e tyre të pasqyrimin të saktë të vendndodhjes së pasurive objekt konflikti në terren me të dhënat e tyre në dokumentet ligjore (AMTP, harta treguese e pasurisë, kartela e pasurisë së paluajtshme), janë elemente të mjaftueshme që do të shërbenin si indice për regjistrimin nga ana e prokurorit të procedimit penal për veprën penale të ekspertimit të rremë.

Subjekti i rivlerësimit, me vendimmarrjen e tij ka cënuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë sepse, i ndodhur përpara denoncimit të një shtetasi për shkelje të rënda të drejtuesve në institucionet arsimore publike, ai rezulton të ketë kryer hetime të cekëta, jo të thelluara dhe jo të plota. Gjithashtu, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke mos kryer asnjë hetim mbi të dhënat dhe faktet e ndodhura në dosje, si dhe mbi ekzistencën ose jo të elementeve të veprës penale të kallëzimit të rremë, duke i mohuar kështu kallëzuesit të drejtën e rishikimit të vendimit civil.

Sa më sipër, trupi gjykues konkludon se nga subjekti i rivlerësimit, jo vetëm që nuk është kryer hetim i thelluar, por nuk është kryer asnjë veprim hetimor për të provuar konsumimin ose jo të veprës penale “Ekspertimi i rremë” (neni 73, pika 2 e Ligjit nr. 96/2016).

Në përfundim, lidhur me rivlerësimin e aftësive profesionale, të çmuar si kriter më vete, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit:

- 1) nuk ka kryer hetim të thelluar, të plotë dhe shterues, me qëllim identifikimin e indiceve apo gjetjen e provave dhe fakteve për të provuar konsumimin ose jo të veprës penale të falsifikimit të dokumenteve.*
- 2) nuk ka kryer analizë të plotë të materialeve ekzistuese në dosje, për të justifikuar vendimin për mosfillimin e procedimit penal.*
- 3) nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për të provuar konsumimin ose jo të veprës penale “Ekspertimi i rremë”;*
- 4) subjekti i rivlerësimit, me vendimmarrjen e tij ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.*

Në përfundim, në vlerësimin në tërësi të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pas rekomandimit të relatorit të çështjes, bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës, nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, e konsideron subjektin e rivlerësimit “me mangësi”, duke treguar cilësi të papranueshme në punë dhe gjykim të dobët.

V. VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMI

1. Trupi gjykues, referuar Aneksit të Kushtetutës (neni D), ligjit nr. 84/2016 (kreu IV), lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, z. Elision Sadiku: Ka pasaktësi në deklarin e burimeve financiare, deklarin të pamjaftueshëm të të ardhurave, si dhe ka burime financiare të paligjshme e, për rrjedhojë, ka burime financiare të ligjshme të pamjaftueshme për kryerjen e investimeve përkatëse. Nga analiza financiare rezulton se për vitet 2011 dhe 2013 subjekti, me të ardhurat e fituara nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, huamarrjet, kreditë, dhuratat, nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për kryerjen e investimeve të deklaruara, si dhe për shpenzimet e kryera.

Sa më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Elision Sadiku, nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

2. Referuar Aneksit të Kushtetutës (neni DH), ligjit nr. 84/2016 (kreu V), lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Elision Sadiku, është i përshtatshëm për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.

3. Referuar Aneksit të Kushtetutës (neni E), ligjit nr. 84/2016 (kreu VI), lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “me mangësi”, për arsye se ka treguar cilësi të papërshtatshme në punë dhe gjykim të dobët.

Bazuar në këto konkluzione, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit:

- a) Nga vlerësimi i secilit prej tri kriterëve,
 - Nuk ka arritur nivel të besueshëm të pasurisë, sepse ka pasaktësi në deklarin e burimeve financiare, deklarin të pamjaftueshëm të të ardhurave, ka burime financiare të paligjshme, si dhe balancë financiare negative për vitet 2011 dhe 2013, duke bërë deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë (neni 61/3 i ligjit nr. 84/2016);
 - Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës (neni 59/b i ligjit nr. 84/2016);
 - Është “me mangësi” në vlerësimin e aftësive profesionale (neni 44/b i ligjit nr. 84/2016);
- b) Nga vlerësimi tërësor i kriterit të pasurisë dhe i aftësive profesionale ka cënuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë (neni 61/5 i ligjit nr. 84/2016).

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, nenin D, pikat 1, 3 e 5, dhe nenin E, pika 4, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në pikën “b” të nenit 44, pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dhe në bazë të nenit 58, pika 1/c dhe pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Elision Sadiku, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.
2. Vendimi i arsyetuar u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 27.07.2018.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta